

Data 07.10.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje oksigjen mjekësor për nevojat e Spitalit Rajonal Memorial Fier” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj .

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): oksigjen-**24111900-4**

Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: **20 365 296 (njëzet milion e treqind e gjashtëdhjet e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjet e gjashtë) Lekë pa TVSH / 206 001.4 (dyqind e gjashtë mijë e një pikë katër) EURO.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor *Spitali Rajonal Memorial Fier* ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi:Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se:

- 1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*
- 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojces 3;

Argumentimi:*Kjo shtojce eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituara.*

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi:Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

ç. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4:

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

- a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;*
- b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit .

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate **3 (tre) viteve** te fundit (**2021, 2022, 2023**), ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e ulët se 40 000 000 lekë/ 404 612.6 Euro**, (pra kjo vlerë e xhiros minimale vjetore nuk tejkalon dyfishin e vlerës së parashikuar të kësaj kontrate.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020, ”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe ne piken 1 dhe piken 2/a dhe 2/c te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/a: *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

- a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit¹, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*

Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

2.3 Kapaciteti teknik:

Kriteri 2.3.1 Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të ulët se **8 000 000 lekë/ 80 922.5 Euro** (pra kjo vlerë totale e kontratave të mëparshme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nuk tejkalon 40% të vlerës së parashikuar të kontratës).

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi për kriterin 2.3.1: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", ne te cilen gjejme te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara;

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

Kriteri 2.3.2 : Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën ISO 9001 mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë" ose/ ekuivalent dhe nëse operatori ekonomik ofertues është prodhues i artikujve të ofruar duhet të paraqesë çertifikatën ISO 9001-2015 ose/ ekuivalent në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Kriteri 2.3.3 Operatori ekonomik ofertues ne rastet kur nuk eshte prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet te paraqese autodeklarate qe furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi eshte konform standarteve te cilesise ISO 9001 mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë" ose/ ekuivalente , te vlefshme, në

përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise dhe i njeh te drejten AK per te verifikuar vetedeklarimin ne procesin e vleresimit te dokumentacionit, dhe ne rast se OE do te shpallet fitues do te paraqese certifikaten ne fjale e cila duhet te jete e vlefshme.

AK rezervon te drejten per verifikimin e vetedeklarimit ne procesin e vleresimit te dokumentacionit dhe ne rastin kur OE ofertues shpallet fitues, duhet te paraqese certifikaten ne fjale.

Argumentimi per kriterin 2.3.2 dhe 2.3.3 : Në bazë të nenit 79/1 , të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe neneve 40 si dhe 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se mallrat objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;b) efijencës së energjisë;c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

Kriteri 2.3.4 Ofertuesi të paraqesë Autodeklarate mbi origjinën e mallit (vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese) per secilin artikull.

Argumentimi për kriterin 2.3.4: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe keto kerkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

Kriteri 2.3.5: Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar (Dokumentat duhet te jene te perkthyer dhe te noterizuara në gjuhën shqip dhe/ose anglisht).

Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës (Dokumentat duhet te jene te perkthyer dhe te noterizuara në gjuhën shqip dhe/ose anglisht).

Argumentimi për kriterin 2.3.5 : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku eshte e cituar: Pika 5. ”Kur është e

dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/entikontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor .

Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t'u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues (*ref. Vendimit të KPP nr. 353/2014*). Si dhe gjithashtu ky kriter u vendos në mbështetje të **Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Date 20.03.2018 të Agjensisë së Prokurimit Publik** (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore **”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit publik”**.

Kriteri 2.3.6 Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten Katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, *te perkthehen në gjuhën shqipe dhe/ose anglisht dhe te noterizohen*). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nepermjet sistemit elektronik të prokurimit.

Argumentimi kriterin 2.3.6: Ky kriter është vendosur nga anetari i Njesisë së Prokurimit që ka specialitet përkatës në lidhje me kriteret teknike si dhe është në përputhje me nenin 4 pika 38/b, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik, si dhe me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se:[...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: [...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].* Paraqitja e katalogjeve për të gjithë artikujt që janë objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përpunueshmërisë së materialeve mjekësore që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST në Shtojcën 6. Objekti i prokurimit është specifik, dhe impakti që ka finalizimi me sukses i kësaj kontrate sjell përfitimi në fushën e diagnostikimit të disa lloje sëmundjesh gjenetike etj., dhe për pasojë në zgjedhjen e terapisë së duhur.

Kriteri 2.3.7: Afati i skadencës për të dy gazet do të jetë: **Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.** Për këtë operator duhet të paraqesin një vetedeklarim ku të deklarohet që skadencat e mallrave do të jete sipas kushteve të përcaktuara në specifikimet teknike.

Argumentimi kriterin 2.3.7: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 ‘Kërkesat për kualifikim’, pika 1 e **Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” ku parashikohet që:** *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.* Vendosja e këtij kriteri në formë deklarative është në përputhje me nenin 1 dhe 2 të e **Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”**.

Kriteri 2.3.8 - Licencë e lëshuar nga QKL ose QKB për tregtim me shumicë të barnave

Argumentimi kriterin 2.3.8 : Argumentim: Ky kriter vihet pasi për tregtimin e barnave në RSH, legjislacioni në fuqi parashikon detyrimin e pajisjes së subjektit që ushtron këtë aktivitet, me licencën përkatëse nga Qendra Kombëtare e Licencimit/ Biznesit.

Kriteri 2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim, të vlefshëm i lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion), për kolaudimin dhe plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë për bombolat të oksigjenit/ ose/ të lëshuar nga prodhuesi për rastin kur bombolat janë të reja, konform legjislacionit në fuqi për enët nën presion.

Argumentim Kriteri 2.3.9: Ky kriter vihet në përputhje me nenin 40 pika 6/c të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilit mund të kërkohen dëshmi për realizimin e testeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike dhe është në përputhje me objektin e kontratës. Është patur parasysh se oksigjeni i gaztë për përdorim mjekësor, mund të tregtohet i ambalazhuar me bombola, të cilat duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë konform legjislacionit për enët nën presion.

Kriteri 2.3.10 Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon gjendje bombola oksigjeni mjekësor / pako bombola, në pronësi ose me qira, minimumi 20 bombola. Për të vërtetuar këtë kriter, operatori ekonomik duhet të paraqesë një dëshmi për pronësinë mbi këto bombola (dokument doganor për importimin e bombolave të oksigjenit) ose kontratën e qirave përkatëse bashkëngjitur dokumentin e pronësisë (dokument doganor për importimin e bombolave të oksigjenit) të qiradhenesit ose cdo lloj dokumenti tjetër ligjor i cili dëshmon disponimin në pronësi të këtyre bombolave.

Argumentimi Kriteri 2.3.10 : Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77, pika 1/c të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, me qëllim garantimin e furnizimit me këtë mall për shkak të vetë specifikave të tij dhe rëndësisë që ka për funksionimin normal të institucioneve spitalore si dhe për të provuar kapacitetin teknik të OE me qëllim përmbushjen e kontratës duke u nisur nga kërkesat e spitalit.

Duke patur parasysh se oksigjeni gaz, furnizohet në bombola, të cilat duhet të jenë të çertifikuara nga institucionet e autorizuar kombëtare për plotësimin e kërkesave të pajisjeve nën presion, sasia e kërkuar është një sasi minimale e bombolave për të cilat AK kërkon të garantohet se disponohen nga OE. Bombolat mund të jenë në pronësi ose të merren me qera. Është patur parasysh se kemi të bëjmë me një bar të regjistruar nga disa OE, që përdoret në të gjitha institucionet spitalore publike dhe private.

Kriteri 2.3.11 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim, të vlefshëm i lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion), për kolaudimin dhe plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë për tankerin e oksigjenit.

Argumentim Kriteri 2.3.11_ : Ky kriter vihet në përputhje me nenin 40 pika 6/c të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilit mund të kërkohen dëshmi për realizimin e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike dhe është në përputhje me objektin e kontrates.

Kriteri 2.3.12 Operatori ekonomik duhet të provojë se në se shpallet fitues, është në gjendje të sigurojë tanker oksigjeni për ta zëvendësuar brenda 10 diteve nga lidhja e kontrates, pranë Autoritetit Kontraktore. Kërkohen minimumi 1 (nje) tanker me kapacitet jo më të vogël se 20 000 litra.

- Në rastin kur OE i ka në pronësi, duhet të paraqesë një dëshmi për pronësinë mbi këto tankera (fature blerje ose dokument doganor për importimin e tankerave të oksigjenit ose cdo lloj dokumenti tjetër ligjor i cili dëshmon disponimin në pronësi të këtyre tankerave) dhe Vertetimin e lëshuar, për kontrollin e kushteve teknike dhe të sigurisë, për enët nën presion tankera/serbatore/cisterna, konform legjisllacionit në fuqi, ku të jenë përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotësimi i standarteve, kushteve teknike dhe të sigurisë. *(vërtetim, të vlefshëm i lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion), për kolaudimin dhe plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë).*
- Në rast se tankerat e oksigjenit do të merren me qira, duhet të paraqitet kontrata ose marrveshja paraprake e qirase e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e kontrates, shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë e pronarit të tankerave të oksigjenit si dhe Vertetimin e lëshuar, për kontrollin e kushteve teknike dhe të sigurisë, për enët nën presion tankera/serbatore/cisterna, konform legjisllacionit në fuqi, ku të jenë përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotësimi i standarteve, kushteve teknike dhe të sigurisë. *(vërtetim, të vlefshëm i lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion), për kolaudimin dhe plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë).* Kontrata ose marrveshja paraprake e qirase duhet të jetë e vlefshme gjatë gjithë kohës së marrveshjes kuader.
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se gjatë gjithë kohës së afatit të MK, do të ketë gjendje brenda territorit të Shqipërisë një sasi rezerve oksigjeni mjekësor të lengshëm, jo më pak se 35.000 litra. Bashkëlidhur deklarates ai duhet të paraqesë dokumentacionin për pasjen në dispozicion në pronësi ose me qira (kontraten apo marrveshjen paraprake të marrjes me qira) të tankerave/serbatoreve me kapacitetin e kërkuar.

Disponimi i tankerave do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, dhe dokumentet provuese do të paraqiten kur Operatori Ekonomik ofertues shpallet fitues.

Argumentim Kriteri 2.3.12 : Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77, pika 1/c të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, ”Për Prokurimin Publik”, me qëllim garantimin e furnizimit me këtë mall për shkak të vetë specifikave të tij dhe rëndësisë që ka për funksionimin normal të institucioneve

spitalore si dhe për të provuar kapacitetin teknik të OE me qëllim përmbushjen e kontratës. Sasia e tankerave të kërkuar, minimumi 1 copë, është në përputhje me nevojat e spitalit. Me qëllim që të mos krijohen vonesa dhe defekte në furnizimin e spitalit me oksigjen, i cili është jetik për këto institucione, si dhe duke patur parasysh faktin që tankerat janë në pronësi të kontraktorit dhe me mbarimin e kontratës mund të tërhiqen prej tij, duhet që OE të provojnë se kanë tankera të kontrolluar dhe çertifikuar nga institucionet përkatëse, duke qenë në gjendje të sigurojë tanker oksigjeni për ta zëvendësuar brenda 10 ditëve nga lidhja e kontratës.

Kërkesat për vërtetimet e kërkuara janë vënë në përputhje me nenin 40 pika 6/c të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilit mund të kërkohen dëshmi për realizimin e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Është patur parasysh se oksigjen i lëngët për përdorim mjekësor, mund të tregtohet i ambalazhuar vetëm me tankera/serbatore/cisterna, që janë të çertifikuar si enë nën presion.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

I. SPECIFIKIMET TEKNIKE

Nr	Emërtimi		Njësia	Sasia për 12 muaj	Përbërësit në %			
1	Oksigjen	Gaz per perdorim mjekësor, i lëngshëm x 100%	Litra	150 000	Oksigjen	O ₂	99.7%	Titulli
					Monoksid karboni	CO	0.13	vmp
					Dioksid Karboni	CO ₂	0.11	vmp
					Ujë	H ₂ O	0.06	vmp
2	Oksigjen	Gaz per perdorim mjekësor, i kompresuar x 100%	Litra	1 600	Oksigjen	O ₂	99.7%	Titulli
					Monoksid karboni	CO	0.13	vmp
					Dioksid Karboni	CO ₂	0.11	vmp
					Ujë	H ₂ O	0.06	vmp

Kushtet e furnizimit - OKSIGJEN LENG - Kërkesat për furnizimin janë si me poshte:

Automjetet

Furnizimi të bëhet me autobotet e furnizuesit të pajisur me :

- Leje për Transport gazra mjekësore nën presion, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
- Leje për Transport gazra mjekësore nën presion të lëshuar nga MNZSH.
- Certifikatë miratimi ADR të lëshuar nga DPSHTRR.

Tankerat e Oksigjenit

Tankerat duhet të certifikohen **nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial** (Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion) dhe duhet të nënshtrohen inspektimeve sipas afateve të përcaktuara ligjore.

Tankeri duhet të instalohet, mirëmbahet dhe kontrollohet periodikisht nga operatori ekonomik.

Syqjrohet përveç matësit manual me litra të jetë i pajisur edhe me matës elektronik të treguesit në sasi të oksigjenit të lëngshëm .

Furnizimi dhe depozitimi i Oksigjenit të lenget do të bëhet në përputhje me kushtet teknike dhe të sigurisë, në tankerat e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor Spitali Rajonal Memorial Fier. - Kapaciteti i Tankerit jo më i vogël se 20 000 litra për godinën qendrore të Spitalit

Gaz për përdorim mjekësor, i lëngshëm,

Mbeshtetur në detyrimin për të furnizuar mallin (oksigjenin e lenget) të ambalazhuar sipas kushteve teknike, Operatori Ekonomik duhet të furnizojë dhe montojë pranë AK, tankerat, të cilët do të jete në përdorim të AK deri në përfundimin e Marrëveshjes Kuadër.

OE ka detyrimin për certifikimin e Tankerave në Inspektoriatin Shtetëror Teknik dhe Industrial (Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion), regjistrimin dhe ndjekjen e kryerjes së inspektimeve sipas afateve të përcaktuara ligjore.

Operatori Ekonomik është përgjegjës për pajisjen e AK me tanker, montimin, lidhjen e tij me rrjetin oksigjenit, kontrollin dhe mirëmbajtjen në përputhje me kushtet teknike dhe legjislativën në fuqi.

Kërkesa të veçanta

1. Brenda 10 ditëve nga lidhja e Marrëveshjes Kuader, Operatori Ekonomik fitues, në marrëveshje me AK, duhet të realizojë furnizimin dhe montimin e tankerave pranë AK si dhe lidhjen e tij me rrjetin oksigjenit. Pas instalimit të tankerit, OE fitues duhet të kryejë regjistrimin dhe certifikimin e tij pranë **Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial**.
2. Për periudhën e zgjatjes së punimeve, kontraktori duhet të marrë masat për të mos ndërprerë furnizimin me oksigjen të shërbimeve spitalore, duke furnizuar më parë rampat e oksigjenit të gaztë me bombola 40 litra me presion 125 bar, sipas nevojave të spitalit.
Sasia e oksigjenit mjeksor të gaztë të konsumuar gjatë ditëve të instalimit të tankerave do të konvertohet në oksigjen të lëngët sipas normativave teknike.
3. Operatori ekonomik duhet të sigurojë, në rast avarie të tankerit të oksigjenit të lëngët, furnizimin me tanker rezerve ose me bombola oksigjeni mjeksor gaz, në rampat e oksigjenit të gaztë, për të siguruar gadishmerinë e furnizimit me oksigjen të shërbimeve spitalore. Sasia e oksigjenit mjeksor të gaztë të konsumuar gjatë kësaj periudhe do të konvertohet në oksigjen të lëngët sipas normativave teknike.
4. Shënim: Oksigjeni i bombolave që do të perdoren sipas pikës 2 duhet të jetë i regjistruar në AKBPM për tregtim në Republikën e Shqipërisë.

Kushtet e furnizimit- OKSIGJEN GAZ - do bëhet me bombola 40 litra sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor

Presioni i mbushjes së bombolave të jetë jo më pak se 125 bar.

Sasia e oksigjenit në bombola të jetë 40 litra për presion 125 bar.

Ambalazhimi të jetë në vëllim 40 litra.

Ambalazhimi i oksigjenit për përdorim mjeksor të jetë në bombolat e shitesit

Bombulat te kene shenjen dalluese “per perdorim spitalor” (O2)

Bombulat të jenë të pastra nga ana estetike(lyera) ,me të gjithë elementët e sigurisë dhe ventilat funksional si dhe në çdo furnizim të shoqërohen me gominat përkatëse për tu montuar në rampat.

Bombolat e oksigjenit duhet te shoqerohen me vertetimin e kryerjes se kontrolleve periodike te **Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial** (Drejtoria e Inspektimit te Pajisjeve nen Presion) ose/ **organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe te sigurisë, per enët nën presion tankera/serbatore/cisterna**, sipas percaktimeve ligjore.

Furnizimi

Transporti i bombolave te oksigjenit mjekësor, i kompresuar, duhet te bëhet me automjete të pajisur me certifikatë ADR te leshuar nga DPSHTRR.

Leje për Transport gazra mjekësore nën presion të lëshuar nga MNZSH.

Transportimi dhe shkarkimi i mallit eshte pergjegjesi e shitesit.

Furnizimi bëhet sipas kërkesave dhe nevojave faktike të Autoritetit Kontraktor për këtë artikull, bazuar në kontratat e lidhura gjate gjithë periudhës së vlefshmerisë së Marrveshjes Kuadër .

Afati i furnizimit nga OE për të dy gazet do të jetë dy (2) ditë pune nga marja e njoftimit (kërkesës) nga punonjësit e AK.

Argumentimi per specifikimet teknike jane vendosur bazuar te procesverbalit nr. **1182/1 date 13/09/2024 te komisionit te hartimit i specifikimeve teknike dhe perllogaritjen e fondit limit** për procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje oksigjen mjekësor për nevojat e Spitalit Rajonal Memorial Fier”** si dhe ne perputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, *“b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë”* si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “për mallrat që do të prokurohen, autoriteti/enti kontraktor parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e*

elementëve më të rëndësishëm përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.”

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT